



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KRYEMINISTRIA**  
MINISTËR SHTETI PËR  
PUSHTETIN VENDOR

agjencia për mbështetjen



e vetëqeverisjes vendore

# RAPORT

## AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Janar – Dhjetor

**2024**

 [www.qeverisjavendore.al](http://www.qeverisjavendore.al)

 [amvv@amvv.gov.al](mailto:amvv@amvv.gov.al)

## **PËRMBAJTJA**

PËRMBAJTJA .....	1
LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE .....	2
AKRONIMET .....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	5
KAPITULLI I.....	6
1 Struktura .....	6
KAPITULLI II.....	7
2 Roli i AMVV-së si Sekretariat Teknik i Këshillit Konsultativ .....	7
KAPITULLI III .....	9
3 Statistika dhe Performanca .....	9
KAPITULLI IV .....	14
4 Integrimi Evropian dhe Projektet.....	14
KAPITULLI V .....	17
5 Kuadri Ligjor .....	17
KAPITULLI VI .....	20
6 Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve në nivel vendor .....	20
KAPITULLI VII.....	24
7 Identifikimi i praktikave të mira dhe hartimi i tyre.....	24

## LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE

<b>Figura 1:</b> Struktura e përgjithshme AMVV .....	7
<b>Tabela 1:</b> Raporti për pjesëmarrjen dhe trajtimin e akteve në takimet e mbajtura përgjatë 2024.....	8
<b>Tabela 2:</b> Llojet e akteve për vitin 2024 .....	8
<b>Tabela 3:</b> Tabela fushave të trajnimit të ofruara: Janar – Dhjetor 2024 .....	15
<b>Tabela 4:</b> Tabela e asistencës në projekt-propozime: Gusht – Dhjetor 2024 .....	16
<b>Tabela 5:</b> Tabela e asistencës në projekt-propozime: Janar – Dhjetor 2024 .....	17
<b>Tabela 6:</b> Trajnime për pushtetin vendor .....	23

## AKRONIMET

AFD	Agjencia Franceze për Zhvillim
AFMIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Financiar në Shqipëri
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BNJ	Bashkëpunimi Ndërbashkiak
BPE	Bashkitë për në Evropë
BtF	Bashki të Forta
BtF2	Bashki të Forta 2
CERV	Programi Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat
DAP	Departamenti i Administratës Publike
EEAS	Shërbimi i Veprimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GNP	Grupi Ndëristitucional i Punës
IDM	Instituti për Demokracinë dhe Ndërmjetësimin
IE	Integrimi Evropian
IPA	Instrument i Paraantaresimit
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KE	Këshilli Evropian
KK	Këshilli Konsulativ
MF	Ministria e Financave
MSHPV	Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor

MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizata Jofitimprurëse
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PI	Plan Integriteti
PRAG	Udhëzues Praktik për Prokurimin dhe Dhënien e Granteve
PV	Plan Veprimi
QQ	Qeveria Qendrore
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SECO	Sekretariati i Shtetit për Çështje Ekonomike
SHAV	Shoqata për Autonominë Vendore
SHKQSH	Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë
SMP	Sistemi i Matjes së Performancës
SNDQV	Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore
TAIEX	Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit të Komisionit Evropian
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2024 e në vazhdim Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka vijuar mbështetjen ndaj 61 njësive të vetëqeverisjes vendore, për konsolidimin e reformës së decentralizimit dhe procesit të integritetit evropian. Në kuadër të përfshirjes në proceset e hartimit të dokumenteve ligjore e strategjike midis të tjerave AMVV ka luajtur një rol kyç (duke kryesuar grupin e punës) në Strategjinë për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, Planit të saj të Veprimit 2023-2025, si edhe Pasaportës së Indikatorëve, si dokumente të një rëndësie parësore, që patën një qasje të qartë gjithëpërfshirëse dhe u realizuan me pjesëmarrjen e një sërë institucionesh shtetërore dhe ku u përfshinë edhe mjaft partnerë zhvillimorë.

AMVV ka forcuar rolin e Këshillit Konsultativ duke nxitur pjesëmarrjen, përfshirjen dhe përfaqësimin e duhur të aktorëve vendorë në të, gjë që ka ndikuar në rritjen e mëtejshme të legjitimitetit të vendimmarrjes që lidhet me çështjet e nivelit vendor. Agjencia ka forcuar punën në dobi të mbështetjes së qeverisjes së mirë, matjes dhe përmirësimit të performancës së shërbimeve publike, rritjes së transparencës e llogaridhënies në qeverisje si dhe mirëmenaxhimit të integritetit institucional në nivel vendor. Po kështu ajo ka vijuar kontributin për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore vendore, si në nivelin ekzekutiv ashtu edhe atë përfaqësues. Gjithashtu, AMVV ka vijuar të jetë e suksesshme edhe në organizimin dhe bashkërendimin e aktorëve kombëtarë institucionalë brenda iniciativave dhe projekteve të donatorëve të huaj me fokus mbështetjen e reformës së decentralizimit dhe përmirësimin e modeleve e praktikave të shërbimeve të bashkive ndaj publikut të gjerë.

Në kuadër të zgjerimit me një numër funksionesh dhe kompetencash të reja, AMVV ka realizuar gjithashtu edhe ndryshimet e nevojshme organizative e strukturore me qëllim përmirësimin dhe rritjen e aftësisë së saj për të kryer me efikasitet funksionet e detyrat aktuale duke i paraprirë detyrave dhe sfidave të shtuara të proceseve integruese në të ardhmen e afërt.

## KAPITULLI I

### 1 Struktura

AMVV që në krijimin e saj ka pasur një mandat të qartë në funksion të mbështetjes së 61 bashkive të reja të krijuara pas miratimit të reformës administrativo-territoriale. Me thellimin e reformës së decentralizimit dhe procesit të integritimit evropian, ky mandat është zgjeruar me një numër funksionesh dhe kompetencash të reja. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2024, AMVV ka rritur kapacitetet e saj, me qëllim që të përmirësojë dhe rrisë aftësinë e saj për të kryer me efikasitet funksionet e detyrat aktuale duke i paraprirë detyrave dhe sfidave të shtuara të proceseve integruese në të ardhmen e afërt.

Struktura aktuale dhe organigrama e AMVV, është përcaktuar me Urdhër të Kryeministrit nr.83, datë 20.05.2024 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes vendore”. Për vitin 2024, organigrama dhe struktura e AMVV kanë ndryshuar duke kaluar në 8 sektorë, 4 drejtori dhe një sektor për financën dhe shërbimet mbështetëse. Sipas këtij ndryshimi numri i punonjësve të AMVV shkon në 32, nga 22 punonjës që përfshiheshin në strukturën e vitit 2023. Struktura e agjencisë paraqitet si më poshtë:

#### **I. Drejtoria e Kuadrit Rregullator dhe Decentralizimit**

1. Sektori i Kuadrit Ligjor
2. Sektori i Decentralizimit

#### **II. Drejtoria e Trajnimit dhe Fuqizimit të Kapaciteteve**

1. Sektori i Vlerësimit të Nevojave dhe Hartimit të Kurrikulave
2. Sektori i Trajnimeve dhe Konsultimeve


#### **III. Drejtoria e Statistikave dhe Performancës**

1. Sektori i Statistikës
2. Sektori i Performancës

#### **IV. Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve**

1. Sektori i Integritimit Evropian
2. Sektori i Projekteve

#### **V. Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**



**Figura 1:** *Struktura e përgjithshme AMVV*

Aktualisht, marrëdhëniet e punës së punonjësve të agjencisë rregullohen me Kodin e Punës. Kriteret specifike dhe procedurat e pranimit në punë bëhen sipas legjislacionit në fuqi, gjithashtu përcaktuar dhe në rregulloren e brendshme të AMVV-së, miratuar me urdhër të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor. Duke patur parasysh ndryshimet e strukturës dhe të organikës së Agjencisë sipas Urdhrit të Kryeministrit, nr. 83, 20.05.2024, lindi nevoja për përmirësimin dhe përditësimin e kuadrit rregullator të brendshëm të AMVV. Në këtë kontekst është përfunduar Rregulloria e brendshme e AMVV.

## KAPITULLI II

### 2 Roli i AMVV-së si Sekretariat Teknik i Këshillit Konsultativ

Këshilli Konsultativ është forum kolegjal bazuar në VKM Nr. 244, datë 17.4.2024 “Për, mënyrën e organizimit e të funksionimit të KK të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, përcakton qartazi funksionet e tij dhe mënyrën e organizimit dhe procesin e konsultimit i cili drejtohet nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor z. Arbjan Mazniku dhe bashkëkryetari z. Aldrin Dalipi. Këshilli Konsultativ ka një përbërje prej 22 anëtarësh me nga 11 anëtarë nga pushteti qendror dhe 11 anëtarë nga vetëqeverisja vendore. KK ka për objekt konsultimi të gjitha projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projekt-politikat dhe projekt-strategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të NJVV-ve. Synimi afatgjatë i krijimit dhe konsolidimit institucional të kësaj strukture është shndërrimi i organeve të vetëqeverisjes vendore në partnerë të rëndësishëm dhe të denjë të qeverisjes qendrore për fushat e tyre të përgjegjësisë dhe funksionet e tyre.

Përgjatë vitit 2024 janë sjellë nga ministritë e linjës për konsultim/mendim 84 projektakte/dokumente në total, ndër të cilat 1 strategji, 59 projektvendime, 14 projektligje, 3 urdhëra, 2 udhëzime, 1 marrëveshje, 1 raport, 1 projekt, 1 analizë dhe 1 dok/platformë. Përgjatë



periudhës janar-dhjetor të vitit 2024 janë organizuar 9 mbledhje dhe janë konsultuar/miratuara 63 projektakte ligjore.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.107/2016”, “Për prefektin e qarkut” është risjellë dy herë për konsultim në këshill. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” (i ndryshuar), i miratuar fillimisht në mbledhjen e datës 8.4.2024, u paraqit për konsultim të dytë në mbledhjen e KK më datë 8.11.2024 pas ndryshimeve të bëra. Ky vendim u miratua më pas në Këshill të Ministrave, pa u konsultuar sërish në Këshillin Konsultativ.

Nr.	Data	Pjesëmarrja nga qeveria qendrore	Pjesëmarrja nga pushteti vendor	Akte te trajtuara
1	19 Shkurt	18%	36%	9
2	8 Prill	36%	45%	6
3	23 Maj	55%	64%	8
4	24 Qershor	45%	18%	5
5	10 Korrik	91%	36%	1
6	29 Korrik	45%	36%	3
7	4 Tetor	27%	27%	6
8	8 Nëntor	55%	45%	9
9	20 Dhjetor	36%	36%	16

Tabela 1: Raporti për pjesëmarrjen dhe trajtimin e akteve në takimet e mbajtura përgjatë 2024




Tabela 2: Llojet e akteve për vitin 2024

## KAPITULLI III

### 3 Statistika dhe Performanca

#### 3.1 Website: [qeverisjavevendore.gov.al](http://qeverisjavevendore.gov.al)

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka krijuar një faqe zyrtare interneti të dedikuar për të garantuar transparencë dhe informim për të gjitha grupet e interesit në lidhje me veprimtarinë e saj. Kjo faqe është e organizuar në nëntë kategori kryesore, ku përfshihet edhe platforma “Dialog Vendor”. Kategoritë janë strukturuar sipas drejtorive përkatëse dhe funksioneve të Agjencisë, duke lehtësuar kështu aksesin dhe përdorimin e informacionit të nevojshëm:

1. AMVV
2. Këshilli Konsultativ
3. Kuadri Rregullator
4. Decentralizimi
5. Performanca
6. Integrimi Evropian
7. Projektet
8. Akademia
9. Platforma “Dialog Vendor”

Në faqen kryesore janë vendosur aktivitetet e realizuara, galeria me foto dhe video, lidhjet e rëndësishme informuese, si dhe informacionet e kontaktit. Një nga risitë e faqes është integrimi i elementeve të mëposhtme:

- a) Harta interaktive që përfshin profilet e 61 bashkive, duke ofruar të dhëna të përgjithshme, financiare dhe informacione nga Sistemi i Monitorimit të Performancës. Harta shfaq gjithashtu bashkitë me performancë të lartë, të cilat mund të shërbejnë si modele suksesi për bashkitë e tjera;
- b) Thirrjet e hapura për aplikime nga bashkitë në projekte të ndryshme, të cilat përmbajnë lidhje të drejtpërdrejta për aplikim dhe dokumentacionin informues.
- c) Kategoria “Akademia”, ku është integruar një kalendar interaktiv që pasqyron në kohë reale trajnimet e planifikuara.

#### 3.2 Platforma: “Dialog Vendor”

Platforma “Dialog Vendor” është një mjet inovativ dhe ndihmues për të gjitha NJVV-të në Shqipëri, i cili për qëllim kryesor forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor dhe atij qendror. Kjo platformë elektronike siguron ndërveprimin efektiv për zgjidhjen e problematikave dhe nevojave të të dy niveleve qeverisëse. Funksionet e kësaj platforme janë:

- a. Konsultimet online midis qeverisë qendrore dhe pushtetit vendor;

- b. Ofrimi i një hapësirë të mbyllur ku kanë akses 61 bashkitë dhe pushtetin qendror;
- c. Asetet e pashfrytëzuara, regjistrimi dhe zhvillimi i projekteve lidhur me to;
- d. Hapësirë për identifikimin e çështjeve/detyrave të evidentuara nga takimet dhe monitorimi i ecurisë së tyre.

### 3.3 Sistemi i matjes së performancës

Standardet e shërbimeve në nivel vendor, performanca e tyre dhe përcaktimi i standardeve minimale kombëtare parashikohen në nenin 33 pika 2 të ligjit Nr.139 “Për vetëqeverisjen vendore”, gjithashtu theksuar dhe në SNDQV 2023-2030. Në këtë kuadër, me Urdhrin nr.213, datë 13.12.2023, “Për disa ndryshime dhe një shtesë në urdhrin nr.17, datë 20.02.2023”, të Kryeministrit, për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e propozimeve ligjore për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet sistemit të matjes së performancës së shërbimeve publike” përcaktohet që mbështetja e veprimtarisë së GNP nga sekretariati teknik kryhet nga AMVV. Ky grup teknik i punës kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i AMVV-së dhe përbëhet nga 11 anëtarë të ministrive përkatëse, 6 anëtarë nga institucionet e qeverisë qendrore dhe 2 anëtarë të shoqatave të qeverisjes vendore.

Faza e konsultimeve, e mbështetur nga projekti BtF, vijoi me realizimin e dy mbledhjeve të GNP, të zhvilluara me pjesëmarrjen e sekretariatit teknik dhe përfaqësuesve të 61 bashkive. Këto mbledhje u fokusuan në diskutimin dhe arritjen e dakordësisë për përzgjedhjen e treguesve të SMP me ndryshimet sipas propozimeve. Treguesit përfundimtarë u miratuan në mënyrë unanime gjatë mbledhjes së GNP.

Procesi ndoqi hapat e mëposhtëm:

1. Fillimisht janë identifikuar **treguesit e performancës** sipas kategorive kryesore (gjatë 2023 dhe janar 2024): shërbimet, menaxhimi financiar dhe transparenca e llogaridhënia. Këta tregues janë rishikuar sipas propozimeve dhe konsultimeve me GNP duke ardhur në formën përfundimtare me treguesit e përdorur në matjen e SMP.
2. Gjatë muajit shkurt është realizuar **manuali përfundimtar** i sigurisë së cilësisë së të dhënave SMP. Metodologjia e sigurimit të cilësisë së të dhënave është një dokument bazë i cili u erdhi në ndihmë NJVV-ve për të mbledhur dhe raportuar të dhëna të sakta për indikatorët e përcaktuar në secilin shërbim vendor.
3. Pas caktimit të koordinatorëve nga çdo NJVV si dhe të koordinatorëve nga AMVV, janë **realizuar trajnime** të përbashkëta të dedikuara paisjes së personelit me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për procesin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave.
4. Pas përfundimit të trajnimeve, nëpërmjet një shkrese zyrtare nga MSHPV filloi procesi i matjes së performancës i cili zgjati dy javë. **Të dhënat e mbledhura** u regjistruan në një platformë digjitale të posaçme, e krijuar për procesin e SMP, nga koordinatorët e caktuar për secilën bashki (kjo platformë ishte e ngritur nga projekti BtF, vënë në dispozicion për SMP).

5. Këto të dhëna të mbledhura iu nënshtuan një **procesi kontrolli dhe verifikimi pararak** ku u unifikuan të dhënat dhe u evidentuan gabimet. Këto të dhëna u përgatitën në një prezantim paraprak për retreat-in e organizuar nga Kryeministria dhe MSHPV.

6. Në 9 mars në Shkodër u organizua **retreat-i** me pjesëmarrës nga Ministrinë e Linjës dhe kryetarët e 61 bashkive, ku u prezantuan gjetjet kryesore dhe pikat kryesore mbi të cilën do të punohej për përmirësimin e shërbimeve vendore.

7. Pas nxjerrjes së draftit të parë të **raportit të performancës** nga ekspertët e mundësuar nga bashkëpunimi me BtF, ky raport kalon përsëri procesin e rishikimit dhe vlerësimit të cilësisë së të dhënave tashmë edhe me krijimin e drejtorisë së statistikës dhe performancës pranë agjencisë. AMVV koordinoi dhe kreu verifikimet e të dhënave me NJVV-të, si dhe për të arritur vlefshmërinë e tyre, përdori edhe burimet administrative zyrtare në vend.

8. Ky raport pas përfundimit të tij i kaloi për **komente** dhe ndryshime, GNP dhe ekspertëve. Pas reflektimit të komenteve u arrit në nxjerrjen e raportit përfundimtar nga AMVV.

9. **Raporti i performancës u finalizua** me publikimin e tij më datë 15 nëntor 2024 në një aktivitet zyrtar me pjesëmarrjen e MSHPV, AMVV si dhe kryetarëve dhe përfaqësuesve të bashkive.

### 3.4 Formula e transfertës së pakushtëzuar

Pas publikimit të rezultateve të Cens-it 2023 dhe ndryshimeve në numrin e popullsisë së bashkive, u evidentua nevoja për rishikimin e formulës së transfertës së pakushtëzuar, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Transferata e Pakushtëzuar rregullohet nga Ligji nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili përcakton madhësinë dhe metodologjinë e shpërndarjes për NJVV-të, duke pasur si faktor kryesor shpërndarjeje, popullsinë relative. Ky rishikim i formulës synon të adresojë nevojat e bashkive që kanë pësuar rënie në numrin e popullsisë, të cilat, sipas formulës ekzistuese, do të përballeshin me një ulje të fondeve të përfituara. Ndryshimi do të bazohet në kushtin ligjor të transfertës së pakushtëzuar, që përcakton se financimi i bashkive nuk duhet të jetë më i ulët se ai i vitit të mëparshëm.

Në këtë kuadër, gjatë muajve korrik dhe shtator, u zhvilluan pesë takime me grupin e punës të ngritur për rishikimin e formulës së transfertës së pakushtëzuar. Ky grup pune përbëhej nga përfaqësues të MF, ekspertë kombëtarë dhe ekspertë të projektit BtF. Gjatë këtyre takimeve u realizuan pesë simulime për të vlerësuar ndikimin që ndryshimet në formulë do të kishin në shpërndarjen e fondeve për çdo bashki. Gjithashtu, u analizuan praktikatat dhe përvojat e vendeve të tjera evropiane të ngjashme me situatën në Shqipëri, për të identifikuar një formulë të përshtatshme. Gjatë takimeve, u hodh fillimisht ideja e krijimit të një fondi shtesë bazuar në performancë. Ky fond u vlerësua të jetë i pavarur nga formula kryesore dhe u konceptua si një grant i bazuar në performancë.

Konsultimet dhe takimet me grupin e punës vazhduan me shtatë takime të tjera të dedikuara specifikisht këtij granti. Në këto takime u përfshinë diskutime me ekspertë të GNP-së mbi

performancën dhe indikatorët që do të përdoren për përllogaritjen e grantit, si dhe mbi heqjen apo shtimin e indikatorëve ekzistues për matjen e performancës për vitin 2024. Gjithashtu, u kryen analiza të rezultateve të bashkive dhe vlefshmëria e indikatorëve për përdorimin e tyre në përfitimin e grantit.

Si përfundim, granti u prezantua për diskutim në Komitetin Drejtues të projektit BtF për vitin 2025, si edhe në Këshillin Konsultativ.

### 3.4.1 Granti i Bazuar në Performancë

Granti i bazuar në performancë është një mekanizëm financiar që mbështet bashkitë të cilat tregojnë performancë të përmirësuar. Ky mekanizëm synon të stimulojë njësitë e vetëqeverisjes vendore në përmirësimin e qeverisjes dhe ofrimin e shërbimeve publike më cilësore për qytetarët.

Qëllimi i Grantit të Performancës është të nxisë përmirësimin e proceseve të qeverisjes në nivel vendor. Përmes këtij mekanizmi, i kombinuar me kornizën e përmirësuar të politikave, synohet rritja e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët. Granti i Performancës është një mekanizëm i bashkëfinancuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Kriteret, procedurat dhe treguesit e performancës për akordimin dhe shpërndarjen e fondit, si dhe të drejtat e donatorëve, do të përcaktohen me një udhëzim të përbashkët të MF dhe MSHPV. Subjektet përfituese dhe zbatuese të këtij fondi janë bashkitë. Treguesit e përzgjedhur për Grantin e Bazuar në Performancë për vitet 2025 dhe 2026 janë:

1. Raportimi i SMP, i cili duhet realizuar brenda afatit, të plotësohen të gjithë treguesit dhe bashkitë të marrin pjesë në trajnimet përkatëse;
2. Plani i Mbarështimit të Pyjeve;
3. Plani Social;
4. Plani i Menaxhimit të Mbetjeve;
5. Plani i Menaxhimit të Arsimit Parashkollor;
6. Plani i Integritetit;
7. Plani për Barazinë Gjinore.

Për asistimin e bashkive lidhur me këto plane, pranë agjencisë do të ngrihet Njësia e Këshillimit për Grantin e Bazuar në Performancë, e cila gjithashtu do të nxjerrë praktika të mira mbi shkrimin e këtyre planeve. Lidhur me procesin e aplikimit dhe vlerësimit është draftuar udhëzuesi i cili përcakton se:

AMVV do të ketë një rol të rëndësishëm si sekretariat teknik për administrimin e aplikimeve duke menaxhuar procesin. Gjithashtu një rol i rëndësishëm është edhe funksioni në verifikimin e rregullsisë së dokumentave të dorëzuara.

## Vlerësimi i mëtejshëm realizohet nga Grupi i Vlerësimit të Aplikimeve

Pas mbylljes së procesit të dorëzimit të aplikimeve dhe verifikimit të dokumentacionit, AMVV i dorëzon Grupit të Vlerësimit të Aplikimeve listën me bashkitë kandidatë për përfitimin e BGP. GVA krijohet me urdhër të MSHPV-së dhe përbëhet nga të paktën 5 anëtarë, të propozuar nga MSHPV, MF dhe ministritë përkatëse të linjës. Secili anëtar përfaqëson ministrinë përgjegjëse për sektorin që mbulon planin e aplikimit. Ky grup ka për detyrë:

- a) Sigurimin e përputhshmërisë së planeve me legjislacionin sektorial;
- b) Vendosjen e elementeve shtesë të përputhshmërisë në bashkëpunim me NJVV-të, në një proces konsultimi që reflekton treguesit e SMP-së dhe PBA.

### 3.5 Tryezat Tematike mbi Performancën e Bashkive dhe GBP

Në kuadër të publikimit të Raportit të Treguesve të Performancës së Bashkive, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia, organizuan tre tryeza tematike në bashkitë e Elbasanit, Lezhës dhe Beratit. Këto tryeza u fokusuan në diskutimin e gjetjeve kryesore të raportit të performancës, sfidave dhe mundësive për përmirësimin e qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e mekanizmit të Grantit të Bazuar në Performancë për vitin 2025.

Tryeza në Elbasan kishte në qendër diskutimin mbi rritjen e autonomisë financiare të bashkive dhe efektivitetin e menaxhimit të burimeve. U evidentua se të ardhurat e veta për frymë janë rritur ndjeshëm në dekadën e fundit, duke reflektuar përmirësime në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore. Diskutimet theksuan nevojën për të zgjeruar më tej kapacitetet menaxheriale të bashkive.

Në Lezhë, fokusi kryesor ishte cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve publike vendore. U vlerësua se investimet për frymë janë rritur me 78% që nga viti 2015, duke ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve bazë si arsimi, shërbimi social, ujësjellës kanalizimet dhe mirëmbajtja e qytetit. U theksua rëndësia e monitorimit të vazhdueshëm të performancës për të garantuar shërbime më të mira dhe më të aksesueshme për qytetarët.

Në Berat, diskutimi u përqendrua në burimet njerëzore dhe integrimin evropian. U prezantuan përpjekjet e bashkive për të rritur kapacitetet institucionale dhe për të siguruar një administratë më efikase dhe të aftë për të përmbushur standardet evropiane të qeverisjes vendore duke rritur pjesëmarrjen në trajnime dhe duke u specializuar në fushën e projekteve. Gjithashtu Berati është një praktikë e mirë për bashkitë e tjera si bashkia me numrin më të lartë të projekteve të huaja të përfutuara.

### 3.6 Projekti: “Open dat’Alb”

Agjencia është fituese e projektit “Open dat’Alb” në bashkëpunim me kompaninë “Spallian” dhe me mbështetjen e Ambasadës Franceze. Spallian është një kompani franceze e specializuar në analizën e të dhënave, zhvillimin e softuerëve dhe këshillimin strategjik. Ndhmon klientët në mbledhjen, përpunimin dhe analizën e informacionit strategjik, duke ofruar zgjidhje inovative dhe të sigurta për shfrytëzimin e Big Data në vendimmarrje.

**Rezultate:**

- Zhvillimi i një ekosistemi për përdorimin e të dhënave të hapura;
- Përmirësimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë publike;
- Krijimi i partneriteteve dhe shkëmbimeve ndërkombëtare;
- Përdorimi i të dhënave për përmirësimin e shërbimeve publike.

Përfituesi kryesor dhe i drejtpërdrejtë është AMVV. Përfituesit e tërthortë janë bashkitë dhe qytetarët, duke shfrytëzuar sistemet e të dhënave të zhvilluara për të krijuar plane të konsoliduara lokale dhe instrumente të tjera të bazuara në të dhëna.

**KAPITULLI IV****4 Integrimi Evropian dhe Projektet**

Procesi i Integritimit Evropian ishte një prioritet kyç për AMVV gjatë vitit 2024, me fokus në mbështetjen e bashkive për përgatitjen dhe përmbushjen e objektivave në nivel vendor. Kjo u realizua përmes bashkëpunimit me projektet e asistencës teknike të BE-së dhe Agjencisë, e cila u përqendrua në katër shtylla kryesore:

- Kapitulli 22 dhe Integrimi Evropian;
- Trajnime për ngritjen e kapaciteteve;
- Mbështetje për aplikime dhe menaxhimin e projekteve me financim të huaj;
- Bashkëpunim me projektet e BE-së.

**4.1 Përgatitja e Pushtetit Vendor për hyrjen në BE**

Gjatë vitit 2024, marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë, si vend kandidat, dhe BE-së u intensifikuan pas hapjes së negociatave grupkapitujt acquis. Në këtë kuadër, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor z. Arbjan Mazniku u përcaktua si Negociatori për Kapitullin 22 të acquis. Ky kapitull ka për qëllim zbatimin e politikave të kohezionit të BE-së në vendet anëtare, duke synuar zhvillimin e tyre rajonal dhe lokal në aspektin ekonomik, social dhe territorial. Në përputhje me këto objektivat, vendet anëtare dhe Shqipëria, si vend aspirues për anëtarësim, duhet të përgatisin legjislacionin dhe strukturat përkatëse për përthithjen e fondeve të BE-së, nëpërmjet zbatimit të projekteve infrastrukturore dhe zhvillimore.

Përgatitja e pushtetit vendor, si një aktor thelbësor në hartimin dhe zbatimin e këtyre projekteve, kërkon një qasje të dyanshme. Nga njëra anë, stafi i agjencisë duhet të përvetësojë njohuritë e nevojshme mbi kuadrin ligjor dhe institucional të Kapitullit 22. Nga ana tjetër, është e domosdoshme që ky staf të organizojë punën për të transmetuar informacionin përkatës tek pushteti vendor, veçanërisht tek Njësitë e Integritimit Evropian në bashki.

Kjo përpjekje synon të sigurojë që bashkitë të jenë të informuara për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe për punën paraprake që duhet realizuar, në mënyrë që ato të jenë të përgatitura për të vepruar kur Shqipëria të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian.

Në lidhje me rritjen e kapaciteteve të brendshme për kryerjen e funksioneve institucionale në kuadër të Kapitullit 22, gjatë periudhës shtator – dhjetor 2024, stafi i AMVV ka marrë pjesë në dy trajnime të specializuara dy ditore mbi kornizën rregullatore dhe institucionale të politikave të kohezionit të BE.

Trajnimi i parë, i realizuar me mbështetjen e Projektit EU4GoodGovernance, u udhëhoq nga znj. Maja Hranilović, eksperte kroate dhe anëtare e grupit negociator të Kroacisë për Kapitullin 22. Trajnimi i dytë u organizua nga ekspertet e Asistencës Teknike për Kapitullin 22 në Shqipëri, znj. Victoria Primhak dhe znj. Valeria Valeri. Përsa i përket përgatitjes së bashkive në kuadër të Kapitullit 22, AMVV ka dhënë një kontribut të rëndësishëm, duke organizuar dhe marrë pjesë në tetë trajnime të zhvilluara nga Projekti “Bashkitë për Evropë” gjatë vitit 2024. Njëkohësisht, është përfunduar aplikimi për TAIEX-in me temë “Roli i bashkive në procesin e integritimit evropian,” i cili do të zhvillohet në fillim të vitit 2025. Për më tepër, është dorëzuar pranë Komisionit Evropian aplikimi për një TAIEX tjetër me temë “Kudri rregullator i ngritjes dhe funksionimit të shoqërive publike lokale.” Ky aplikim synon të sigurojë ekspertizën e nevojshme për bashkitë në krijimin dhe bashkëpunimin me shoqëri vendore për ofrimin e shërbimeve publike cilësore, në përputhje me standardet e BE-së.

Së fundmi, është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm për të siguruar një financim prej 9 milionë € nga fondet IPA III të Bashkimit Evropian për pushtetin vendor në Shqipëri. Ky financim do të mbështesë vazhdimin e projekteve të rëndësishme, si faza e dytë e Projektit EU4GoodGovernance, faza e tretë e Projektit EU4Municipalities dhe projekte të tjera që do të ofrojnë asistencë teknike të avancuar në kuadër të Kapitullit 22.

#### 4.2 Trajnimeve, workshop, seminare dhe grupe pune për rritjen e kapaciteteve të bashkive në kuadër të integritimit në BE

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të njëjësive të Integritimit Evropian në çdo bashki, gjatë vitit 2024, AMVV ka organizuar **9 aktivitete, 7 trajnime dhe 2 seminare, me 443 pjesëmarrës, nga të cilët 385 persona** kanë ndjekur trajnimet e organizuara në bashkëpunim me ASPA. Këto aktivitete u mbështetën me ekspertizë nga projekte si BpE, EU4GoodGovernance dhe SIGMA dhe AKKSHI. Fokus kryesor ishin menaxhimi financiar, shkrimi i projekteve, procedurat PRAG dhe politikave të BE-së. Synimi ishte përmirësimi i shërbimeve publike dhe zbatimi i fondeve sipas standardeve evropiane për të mbështetur integrimin e Shqipërisë në BE.



Tabela 3: Tabela fushave të trajnimit të ofruara: Janar – Dhjetor 2024



### 4.3 Mbështetja në aplikime dhe menaxhimin e projekteve për bashkitë

Gjatë muajve gusht dhe dhjetor 2024, AMVV realizoi gjetjen, shqyrtimin dhe publikimin në faqen zyrtare të 33 thirrjeve të hapura për projekt-propozime, të financuara nga BE të drejtuara NJVV-ve. AMVV ofroi informacion të unifikuar për të gjitha bashkitë, duke u fokusuar në identifikimin e thirrjeve të përshtatshme për programet HORIZON EUROPE, CERV, URBACT dhe IPA Interreg, për të mbështetur bashkitë në mundësitë për financime të huaja.

Muaji	Thirrjeve të publikuara	Thirrjet
Gusht	4	EU4SocialCare, EU4LMI, Town Twinning (CERV)
Shtator	6	Interreg IPA South Adriatic, DALIA, Fondi i Vishegradit+, CLIMAAX, Community NEB (Programin EIT Community), Komunitetet e Zgjuara (DS4SSCC)
Tetor	4	Demokracia Deliberative (COE), WBF Move, Planifikimi Urban Rezistent (Horizon Europe), AKMC
Nëntor	11	INSPIRE, Rethinking Urban Spaces Towards Climate Neutrality (Horizon Europe), Zero-pollution cities (Horizon Europe), Mobility Management Plans and Behavioural Change (Horizon Europe), Integrated Peri-urban Areas in the Transition towards Climate Neutrality (Horizon Europe), Nature-based Solutions in the Mediterranean (MBC), HERITAGE-ECCCH-01-01 (Horizon Europe), HERITAGE-ECCCH-01-02 (Horizon Europe), HERITAGE-ECCCH-01-03 (Horizon Europe), HERITAGE-ECCCH-01-04 (Horizon Europe), HERITAGE-ECCCH-01-05 (Horizon Europe)
Dhjetor	8	URBACT Pioneers Accelerator (URBACT), URBACT City Festival 2025 (URBACT), BioProtect Associated Regions Call, Networks of Towns (CERV), “Circular Economy Park” nën Programin Interreg (VI-A) IPA CBC “Greqi-Shqipëri” 2021–2027, BeMed Call for Micro-Initiatives (CMI), “Rights of the child and children’s participation” (CERV), Citizens' Engagement and Participation (CERV)

**Tabela 4:** Tabela e asistencës në projekt-propozime: Gusht – Dhjetor 2024

Gjatë vitit 2024, krahas identifikimit dhe publikimit të thirrjeve, AMVV ofroi asistencë teknike dhe orientime për 19 bashki që shprehën interes për aplikime në thirrjet e hapura të financuara nga BE, si EU4SocialCare dhe EU4LabourMarketInclusion. Shërbimi përfshinte mentorime, shqyrtimin e materialeve të aplikimeve, asistencë në menaxhimin e raportimeve dhe informacion mbi procedurat e rimbursimit të TVSH-së dhe bashkëfinancimit të projekteve. Në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor, AMVV mbështeti drejtpërdrejtë përgatitjen e 7 projekt-propozimeve për 6 bashki, duke zgjeruar mundësitë për përfitimin e fondeve ndërkombëtare dhe kombëtare.

Nr.	Bashkia	Muaji	Akronimi i Thirrjes
1	Libohovë	Tetor	CLIMAAX
2	Belsh	Nëntor	AKMC
3	Vau i Dejës	Nëntor	INSPIRE
4	Skrapar		
5	Peqin		
6	Belsh	Dhjetor	AKR
7	Cërrik		

**Tabela 5:** Tabela e asistencës në projekt-propozime: Janar – Dhjetor 2024

Në bazë të informacionit të mbledhur nga vetë-deklarimet e Njësive të Integritimit Evropian në Platformën e krijuar nga projekti BpE, AMVV përgatiti kapitullin mbi performancën e bashkive në projektet me financim të huaj për periudhën 2017-2024, i cili u përfshi në raportin vjetor mbi performancën e bashkive.

#### 4.4 Bashkëpunimi me Projektet e financuara nga BE ku AMVV është përfituese direkte

AMVV është partner dhe përfitues direkt i projekteve financuar nga BE, që synojnë forcimin e rolit të bashkive dhe kapaciteteve të stafit të tyre. Projektet kryesore përfshijnë “Municipalities for Europe”, “EU4Municipalities I”, “ReLoad 2” (të mbyllura në 2024), “EU4GoodGovernance” (filloi në 2024 për 3 vjet), “Reload 3” dhe “EU4Municipalities II” (fillojnë në 2025), si dhe projekte të tjera si OECD SIGMA dhe VNG Hollandë.

AMVV kontribuon në hartimin e aktiviteteve dhe asiston në organizimin e tyre, duke siguruar pjesëmarrjen e stafit të bashkive dhe të vetë AMVV. Gjatë vitit 2024, këto projekte ndihmuan bashkitë në përmirësimin e konsultimeve publike, bashkëpunimit me shoqërinë civile, bashkëpunimit ndër-bashkiak, ushtrimin e kompetencave ligjore dhe rritjen e kapaciteteve për shkrimin e projekteve të financuara nga BE.

AMVV gjithashtu realizoi një bashkë-aplikim me Shoqatën e Bashkive të Hollandës në thirrjen MATRA të financuar nga Ambasada e Hollandës në Shqipëri. Gjatë vitit 2024, Agjencia tregoi përkushtim të lartë për rritjen e kapaciteteteve të bashkive dhe mbështetjen e integritimit evropian në nivel vendor.

## KAPITULLI V

### 5 Kuadri Ligjor

#### 5.1 Përgatitja e Manualeve Orientuese për strukturat e reja në NJVV

AMVV në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave për rritjen e pagave të NJVV-ve, hartoi në përputhje me të manuale orientuese për organizimin e strukturave dhe organigramave të bashkive. Manualët u hartuan sipas tipologjive të bashkive duke u bazuar në numrin e

popullsisë së tyre. Prej muajit gusht, 27 bashki të cilat kërkuan asistencë teknike u ndihmuan nga punonjësit e AMVV-së, për të bërë të mundur përshtatjen e strukturave të reja sipas kërkesave dhe nevojave të tyre. Në përputhje me konceptin e pagave horizontale, me anë të manualeve është synuar ndarja e administratës së bashkisë në kategorinë politikë-bërëse dhe monitoruese dhe kategoria tjetër ajo ekzekutive e shërbimeve dhe funksioneve. Deri më tani, janë zhvilluar tre takime informuese në bashkëpunim me Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil (KMSHC), si dhe me bashkitë e vendit për sqarimin e manualeve orientuese mbi implementimin e strukturave të reja. Në bashkëpunim me strukturat e Komisionerit, në këto takime është qartësuar koncepti i kategorive të punonjësve, ndarja e tyre në shërbim civil, punonjësit që trajtohen me kod pune dhe punonjësit mbështetës/administrativ.

## 5.2. Përditësimi i paketës ligjore në funksion të NJVV-ve

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor të 2024, është miratuar një paketë e gjerë ligjore në fokus kryesor njësitë e vetëqeverisjes vendore, me pikënisje vendimin për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të MSHPV<sup>1</sup> dhe më tej, fuqizimin e rolit të AMVV dhe Këshillit Konsultativ përmes akteve përkatëse të miratuara.<sup>2</sup>

*Inter alia*, kjo periudhë shënon arritje gjithashtu në miratimin e:

- Ligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për projektin “Bashki Të Forta, Faza 2”;
- Vendimit “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për projektin “Bashki Të Forta, Faza 2”;
- Vendimit ndryshues “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore, institucionet në varësi të tyre dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”;
- Urdhrit “Për ngritjen e GNP-së për hartimin e ligjit të ri të bashkëpronësisë”;
- Urdhrit “Për ngritjen e GNP-së për zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve dhe të zgjedhurëve vendorë”;
- Urdhrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”;
- Urdhrit “Për ngritjen e GNP-së për hartimin e mekanizmit pilot “Decentralizim Pilot”;
- Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qendrës për Kërkim-Zhvillimin Rajonal e Vendor (UT) dhe AMVV-së “Për vendosjen e bashkëpunimit në zhvillimin e projekteve të përbashkëta për çështje që prekin NJVV-të” dhe Aneksit bashkëlidhës.
- Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor.

<sup>1</sup> Miratuar në vitin 2023.

<sup>2</sup> Vendimi nr.227 datë 9.4.2024, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore” dhe vendimi nr. 244 datë 17.4.2024, “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”.

Në vijim, është arritur të ndryshojë paketa ligjore e funksionimit të AMVV-së, si dhe janë hartuar akte nënligjore në dobi të pushtetit vendor. Në këtë kontekst, është miratuar vendim i ri i Këshillit të Ministrave për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë. Po në këtë frymë, janë miratuar ndryshimet për mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të KK-së për të vendosur norma të reja që përbëjnë risi në konfigurimin e këtij organi. Në lidhje me bashkëpunimin me donatorët, është miratuar marrëveshja me Ambasadën e Zvicrës në Shqipëri për projektin “Bashki të Forta 2”, si dhe është ratifikuar në Kuvend me ligj të veçantë.

Në kuadër të thellimit të decentralizimit, është miratuar Urdhri i Kryeministrit për aplikimin e mekanizimit pilot “Decentralizimi Horizontal”, me qëllimin e ushtrimit të përbashkët të disa kompetencave nga qeveria qendrore dhe pushteti vendor në fushën e bujqësisë, arsimit dhe kujdesit shëndetësor. Ky proces do të zgjasë 1 vit, për të vlerësuar në fund nëse këto kompetenca mund të absorbohen nga bashkitë në të ardhmen. Agjencia ka hartuar Urdhrin e Kryeministrit për ngritjen e grupit të punës për ndryshimet ligjore në ligjin për administrimin e bashkëpronësisë. Deri në muajin dhjetor, janë përfunduar procedurat e konsultimit dhe është hartuar drafti përfundimtar i ligjit të ri. Për t’iu ardhur në ndihmë NJVV-ve, Agjencia ka vijuar punën për ngritjen e qendrës së trajnimeve të pushtetit vendor, e cila do të mbulojë të gjithë nivelet e punonjësve por dhe të zgjedhur vendor. Në këtë kuadër, është hartuar urdhri i Kryeministrit për ngritjen e grupit të punës për krijimin e qendrës së trajnimeve të pushtetit vendor (Akademia).

### **5.3. Raporti i monitorimit per vitin 2023 të SNDQV-së**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 227, datë 9.4.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”, është përgatitur raporti i monitorimit për vitin 2023, të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2023-2025.

Raporti i publikuar gjatë vitit 2024, paraqet vitin e parë të raportimit mbi ecurinë dhe zbatimin e dokumentit strategjik dhe planit të veprimit. Gjatë procesit për grumbullimin e të dhënave për raportin, janë zhvilluar dy workshope, me institucionet qendrore dhe ato vendore, përgjegjëse për zbatimin e masave/aktiviteteve sipas planit të veprimit, me fokus informimin në lidhje me procesin e raportimit, për 17 institucione qendrore dhe 61 bashki. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik 2024, paraqet ecurinë e zbatimit të masave për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2023.

Nga një vështrim i përgjithshëm, nga 158 masa të parashikuara për vitin 2023, vërejmë se 35 masa janë zbatuar në nivelin 100%, 46 masa janë zbatuar në nivelin 51%-99%, 51 masa janë në proces realizimi dhe për 26 masa nuk ka filluar ende zbatimi ose përqindja e zbatimit është shumë e ulët.

Për sa i përket 6 qëllimeve politike kanë patur një ecuri të tillë ku, qëllimi politik nr.1 në zbatimin total të masave shënon rezultatin prej 51%, qëllimi nr.2 shënon një nivel realizimi prej 53%, qëllimi nr.3 nivel realizimi prej 60%, qëllimi nr.4 nivel realizimi prej 43%, qëllimi politik nr.5 nivel realizimi prej 66%, ndërsa qëllimi politik nr.6 shënon rezultat më të dobët me 30% krahasuar me qëllimet e tjera për sa i përket zbatimit të masave.

Në përmbushje të objektivave strategjik dhe matjen e arritjeve nëpërmjet indikatorëve të performancës në dokumentin strategjik, AMVV, deri në vitin 2024 ka asistuar 28 bashki në hartimin e Planeve të Integritetit. Për sa i përket fushës së emergjencave civile, 28 bashki kanë hartuar plane vendore të emergjencave civile. Një tjetër arritje vërehet dhe në fushën e shërbimeve sociale, ku 20 bashki kanë rritur shkallën e ofrimit të shërbimeve sociale me bazë komunitare. Progresi reflektohet edhe në përqindjen e adresimit të rekomandimeve të qeverisjes vendore dhe forcimin e punës së Këshillit Konsultativ.

## KAPITULLI VI

### 6 Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve në nivel vendor

Në kuadër të iniciativës së MSHPV për fuqizimin e burimeve njerëzore të NJVV-ve, dhe në zbatim të Strategjisë së Decentralizimit 2023-2030, me Urdhër të Kryeministrit nr.6 datë 12.01.2024, u krijua GNP “Për zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve dhe të të zgjedhurve vendorë”. Ky grup u angazhua në ngritjen e Akademisë së Pushtetit Vendor, një strukturë që synon përmirësimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe rritjen e efikasitetit të NJVV-ve, përmes trajnimeve të avancuara dhe hartimit të kurrikulave të dedikuara për 41 funksionet e qeverisjes vendore.

GNP, nën drejtimin e Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, me mbështetjen e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në rolin e sekretariatit teknik, organizoi tre mbledhje të grupit të punës gjatë periudhës raportuese, me pjesëmarrjen e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, DAP, ASPA, SHAV, SHKQSH dhe projekteve donatore.

Në shtator 2024, përfaqësues të NJVV-ve shprehën angazhimin për bashkëfinancimin e Akademisë. Në këtë kuadër, me vendim të mbledhjes të Asamblesë të Përgjithshme të SHAV, u dakordësua angazhimi i Qeverisjes Vendore në bashkëfinancimin e Akademisë në vlerën 50% për shpenzimet operationale dhe të trajnimeve.

GNP ka miratuar ngritjen e Akademisë së Pushtetit Vendor si OJF, subjekt i kompetencave të përbashkëta, në përputhje me Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 14/5 dhe Ligjin Nr. 8788/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve”. Akademia do të financohet në mënyrë të barabartë nga Qeveria Qendrore dhe Qeverisja Vendore për kostot operationale dhe të trajnimit, ndërsa kostot e investimit fillestar do të mbulojnë plotësisht nga Qeveria Qendrore.

#### 6.1 Aktivitete të zhvilluara në kuadër të grupit ndërinstitucional të punës

Gjatë mbledhjeve të GNP, janë diskutuar dhe miratuar dokumentet që mbulojnë disa aspekte kyçe të zhvillimit të Akademisë së Pushtetit Vendor. Këtu përfshihen plani i punës për vitin 2024, kalendari i trajnimeve për fazën tranzitore, dhe matrica e bashkëpunimit mes aktorëve kryesorë (AMVV, ASPA, SHAV, SHKQSH). Po ashtu, është hartuar raporti i hartëzimit të trajnimeve që identifikon aktivitetet e rritjes së kapaciteteve dhe planifikimet për vitin 2024. Dokumenti Green Paper ka analizuar opsionet për dizenjimin e Akademisë, ndërsa raporti për

praktikat më të mira të platformave të menaxhimit të njohurive ka ofruar informacion mbi shembuj konkretë të platformave të suksesshme të dedikuara për qeverisjen vendore. Përlllogaritja e kuotës së Akademisë dhe dokumenti White Paper janë përgatitur për të udhëhequr krijimin dhe funksionimin e strukturës, duke përfshirë aspekte organizative, financiare dhe ligjore.

### **Faza tranzitore dhe roli i AMVV-së**

Duke marrë në konsideratë që ngritja e Akademisë të Pushtetit Vendor parashikohet gjatë vitit 2025, grupi i punës dakordësoi që viti 2024 të shërbente si një vit tranzitor ku AMVV do të ishte institucioni përgjegjës për koordinimin e iniciativave për ofrimin e trajnimeve në nivel vendor. Në këtë kuadër, me miratimin e strukturës dhe organikës të re të AMVV, pranë agjencisë u ngrit Drejtoria e Trajnimeve dhe Fuqizimit të Kapaciteteve, përgjegjëse për koordinimin dhe ofrimin e trajnimeve për pushtetin vendor, bazuar në matricën e bashkëpunimit të miratuar nga GNP.

### **Konsultime**

Për ngritjen e Akademisë së Pushtetit Vendor, AMVV, me mbështetjen e projektit BtF, zhvilloi një fazë konsultimi me aktorët e sistemit, donatorët dhe përfaqësues të pushtetit vendor. Gjatë muajit mars, AMVV organizoi fazën e parë të konsultimeve për krijimin e një akademie për Qeverisjen Vendore. Ky proces u realizua përmes një pyetësori online dhe intervistave individuale, ku morën pjesë aktorë të rëndësishëm si DAP, ASPA, MF, përfaqësues të bashkive të ndryshme si Dimal, Mirditë, Tiranë dhe Kavajë, si dhe SHAV, SHKQSH dhe KE.

Në shtator, MSHPV zhvilloi një takim konsultues me kryetarët e bashkive dhe përfaqësues të pushtetit vendor për të diskutuar modelin e bashkëfinancimit të akademisë. Në këtë takim morën pjesë kryetarët e bashkive të Durrësit, Elbasanit, Kavajës, Cërrikut, Mirditës, Përmetit, Belshit, si dhe Nënkryetari i Bashkisë Tiranë dhe Drejtori Ekzekutiv i SHAV.

### **Seminar për Platformën e Menaxhimit të Njohurive dhe Praktikave të Mira**

Gjatë muajit maj, AMVV në bashkëpunim me projektin BtF, organizuan seminarin për Platformën e Menaxhimit të Njohurive si një prej shërbimeve kryesore që pritet të ofrojë Akademia. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga ASPA, SHAV, SHKQSH, KE, AKSHI, DAP dhe Bashkia Tiranë. Seminari u lehtësua nga 2 ekspertë kombëtar si dhe 2 ekspertë nga Universiteti i Luzernit. Gjatë seminarit u diskutua metodologjia për identifikimin dhe gjenerimin e produkteve kyçe që mund të përfshijë kjo platformë si dhe metodologjia për identifikimin dhe hartimin e praktikave të mira.

### **Zhvillimi i fokus grupeve për modulet e trajnimeve**

Gjatë periudhës raportuese, janë zhvilluar takime online për konsultimin e moduleve të trajnimeve, si pjesë e mbështetjes për zhvillimin e kapaciteteve të NJVV-ve dhe bashkëpunimit me aktorët e tryezës. Këto takime përfshijnë: fokus grupi për hartimin e moduleve për Komisionet e Përhershme të Këshillave Bashkiakë, në bashkëpunim me projektin BtF dhe

aktorët lokalë, fokus grupi për Vlerësimin e Kapitalit Natyror të Bashkive, në bashkëpunim me OSBE-në, dhe një takim koordinues për hartimin e modulit të "Planifikimit të Territorit", me pjesëmarrjen e ASPA, OSCE dhe BtF.

### Hartimi i kurrikulës të menaxhimit të integruar të mbetjeve

Në prill 2024, AMVV, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, organizoi një takim me aktorët e sistemit dhe partnerët kryesorë për të prezantuar outline-n e kurrikulës për menaxhimin e integruar të mbetjeve, me qëllim mbështetje për NJVV-të në ofrimin e këtij shërbimi sipas standardeve. Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga AMVV, MTM, ASPA, BtF2, KFW, GIZ, SECO, JICA, AFD, EEAS dhe World Bank. Pas analizës së moduleve ekzistuese, ekspertët sugjeruan hartimin e një kurrikule të re që do të përfshinte pesë module, duke përfshirë ekonominë qarkulluese dhe qëndrueshmërinë financiare. Kurrikula do të miratohet gjatë vitit 2025.

### Trajnime për pushtetin vendor

Në kuadër të zhvillimit dhe forcimit të kapaciteteve të pushtetit vendor, janë realizuar një sërë trajnimesh dhe takimesh rajonale me këto të dhëna kryesore:

- **Numri i moduleve të trajnimit: 17 module**
- **Numri i trajnimeve: 77 trajnime**
- **Pjesëmarrës gjithsej: 1651 persona, të cilët përfshijnë:**
  - **Këshilltarë të trajnuar: 605 këshilltarë.**
  - **Staf administrate të trajnuar: 1046 persona.**

Këto aktivitete janë realizuar me qëllim përmirësimin e performancës dhe aftësive profesionale të përfaqësuesve të pushtetit vendor, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe efikasitetin administrativ.

Nr	Trajnimet	Donatori/ Projekti	Pjesëmarrja e Bashkive		
			Staf NJVV	Këshilltarë	Gjithsej
1	Komisionet e Këshillave Bashkiak për arsimin parashkollor dhe menaxhimin e mbetjeve	SHAV, ASPA, SHKQSH	53	192	248
2	Komisionet e Këshillave Bashkiak për ekonomi financa- barazia gjinore	BtF	47	152	199
3	Komisionet e Këshillave Bashkiak të Integritit Evropian	BpE	-	117	117
4	Komisionet e Këshillave Bashkiak për modulën e Lidërshiptit	SHAV, ASPA, SHKQSH, Financat Lokale, BtF	-	144	144

5	Sistemi i Matjes së Performancës	BtF	220	-	220
6	Trajnimi PRAG	BpE	205	-	205
7	Trajnimi për Integrimin Evropian	BpE	44	-	44
8	Trajnimi për Arsimin Parashkollor	BtF	83	-	83
9	Trajnimi për Kapitalin Natyror të Bashkive	OSBE	46	-	46
10	Trajnimi për Financat Vendore	ASPA/ Financat Vendore	148	-	148
11	Trajnimi për Menaxhimin Financiar të projekteve të BE	BpE	103	-	103
12	Trajnim online për aplikim në thirrjen CERV	BpE	58	-	58
13	Njësitë e reja të Integritimit	BpE	33	-	33

**Tabela 6:** Trajnime për pushtetin vendor

### Trajnim Peer to Peer

Bashkia Kamëz kërkoi asistencën e AMVV-së për trajnimin e 6 punonjësve të rinj të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit për aspektet ligjore të funksionit të tyre si dhe procedurave të punës së përditshme. Në këtë kuadër, AMVV në bashkëpunim me stafin e IMT-së së bashkisë Tiranë zhvilluan trajnimin dy ditor për punonjësit e bashkisë Kamëz. Trajnimi u zhvillua pranë zyrave të IMT-së Tiranë.

### 6.2 Monitorimi i Planeve të Integritetit dhe asistenca ndaj bashkive për hartimin e planeve të reja

AMVV, në kuadër të PI ka marrë pjesë në procesin e hartimit dhe konsultimit të planeve të integritetit, duke u mbështetur nga ana teknike dhe metodologjike nga ekspertët e IDM Albania. Integriteti institucional dhe lufta ndaj korrupsionit konsiderohen si prioritet kryesor të qeverisë Shqiptare. Prioritizimi i kuadrit anti-korrupsion është jetësuar nëpërmjet forcimit të kompetencave dhe kapaciteteve të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, koordinimit dhe zbatimit të nismave anti-korrupsion.

**Hartimi i PI:** AMVV është një aktor kryesor në mbështetjen e NJVV-ve që ende nuk e kanë nisur ose janë në proces të hartimit të planeve të integritetit. Në këtë kontekst, agjencia për vitin 2024 ka asistuar në inicimin e bashkive të cilat kanë shprehur interesin për hartimin e planit të integritetit. Në këtë prizëm AMVV ka asistuar **12 bashki** për hartimin e Planeve të integritetit,



përkatësisht bashkitë Shkodër, Fushë-Arrëz, Vlorë, Libohovë, Prrenjas, Finiq, Konispol, Divjakë, Gramsh, Peqin, Kolonjë dhe Dropull. Procesi nisi me ngritjen e grupit të punës nga agjencia dhe nga bashkitë përkatëse me të cilat u zhvilluan takime konsultuese deri në finalizim të draftit përfundimtar.

Deri më tani, **35 bashki kanë hartuar PI**, përkatësisht në bashkitë Elbasan, Gjirokastrë, Mat, Patos, Mallakastër, Durrës, Belsh, Përmet, Pogradec, Bulqizë, Berat, Tiranë, Lezhë, Kukës, Pukë, Kavajë, Himarë, Maliq, Shijak, Has, Roskovec, Librazhd, Lushnje, Gramsh, Divjakë, Peqin, Kolonjë, Konispol, Finiq, Dropull, Shkodër, Fushë Arrëz, Vlorë, Libohovë dhe Prrenjas. 29 bashki i kanë miratuar Planet e Integritetit në Këshill Bashkiak, ndërkohë që 6 bashki janë në proces. Gjatë vitit 2025 AMVV do të vijojë me asistencën për të nxitur bashkitë për hartimin dhe miratimin e Planeve të Integritetit në të gjitha bashkitë e vendit.

**Monitorimi i PI:** që prej fillimit të vitit 2024, AMVV është angazhuar në procesin e monitorimit të planeve të integritetit (realizimit të masave/aktiviteteve të tyre) të miratuara nga bashkitë. Për realizimin e këtij procesi për vitin 2023, i cili monitorohet në vitin pasardhës, AMVV ka koordinuar dhe monitoruar **16 bashki** që kanë miratuar tashmë një PI.

Nga monitorimi rezultoi se në këto bashki është vënë re një progres i qëndrueshëm për sa i përket parametrave të transparencës dhe të zbutjes së riskut të integritetit. Kështu nga monitorimi evidentohet risia e hartimit të planeve vjetore për kualifikimin dhe trajnimin e administratës bashkiake, miratimi i kodit të sjelljes si dhe plotësimi i programeve të transparencës, të cilat janë të publikuara në faqet zyrtare të NJVV-ve. PI-të kanë sjellë efektet të tjera pozitive në procedurat e prokurimeve publike, qartësimin e detyrave të personelit. Progres është konstatuar në ngritjen dhe funksionimin e njësive të sinjalizuesve, gjithashtu janë krijuar e plotësuar regjistrat për shmangien e konfliktit të interesit dhe ai për ankesat dhe kërkesat. Shkalla e përgjithshme e realizimit të planeve të integritetit rezulton **në mesataren prej 58%**.

Procesi i monitorimit u përmbyll me hartimin e raporteve të monitorimit për secilën bashki, raportit përmbledhës dhe përlllogaritjen e indeksit të integritetit sipas metodologjisë së miratuar.

Hartimi i raporteve të monitorimit të planeve të integritetit dhe realizimi i pjesës më të madhe të masave të parashikuara, ka përmbushur objektivin e projektit IPA, i cili ka sjellë një financim prej 600 mijë euro në buxhetin e shtetit.

## KAPITULLI VII

### 7 Identifikimi i praktikave të mira dhe hartimi i tyre

#### 7.1 Procedura e marrjes me qira të mjediseve çerdhe dhe kopshte për bashkinë Tiranë

AMVV ka evidentuar si praktikë të mirë transformimin e godinave ekzistuese në çerdhe dhe kopshte nga bashkia Tiranë. Ky proces përfaqëson një hap të rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për fëmijët. Vlerësimi i cilësisë së kësaj nisme mbështetet në përmbushjen e standardeve të infrastrukturës, sigurisë dhe edukimit, si dhe në ndikimin pozitiv në zhvillimin kognitiv, social dhe emocional të fëmijëve.

Kjo qasje e bashkisë Tiranë përfaqëson një model që mund të adaptohet nga bashki të tjera për të adresuar nevojat e komunitetit në sektorin arsimor dhe social.

## **7.2 Instalimi i paneleve fotovoltaike në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore**

Një praktikë e mirë tjetër e evidentuar është edhe “Instalimi i paneleve fotovoltaike në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, e zbatuar nga Bashkia Elbasan. Kjo praktikë ka rezultuar nga implementimi me sukses i projektit “Sunny Schools”, realizuar me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, përmes instalimit të paneleve fotovoltaike në shtatë shkolla. Projekti ka dëshmuar përfitime të shumta, duke përfshirë uljen e kostove energjetike, përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe promovimin e përdorimit të energjisë së pastër dhe të qëndrueshme. Në këtë kuadër, kjo praktikë është zhvilluar dhe prezantuar si një model për t’u ndjekur nga të gjitha bashkitë që shfaqin interes për të përfshirë këto tipe investimesh inovatore, të cilat përfaqësojnë një drejtim të sigurt drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe modernizimit të teknikave të gjenerimit të energjisë.

## **7.3 Rrjeti i qendrave sociale të Bashkisë Korçë**

Bashkia Korçë ka zhvilluar një model të suksesshëm për mbështetjen e grupeve në nevojë, përmes një rrjeti qendrash sociale që ofrojnë shërbime bazë dhe të specializuara për të moshuarit, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet vulnerabël si romët dhe egjiptianët. Zbatimi i VKM 518/2018 dhe një qasje inovative kanë mundësuar adresimin e sfidave sociale, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe reduktimin e izolimit social. Rrjeti i qendrave ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe integrimin social të përfituesve, duke u kthyer në një model të qëndrueshëm dhe efektiv për praktikatat sociale në nivel lokal dhe kombëtar.

## **7.4 Procesi i legalizimeve në Bashkinë Shijak**

Bashkia Shijak ka zbatuar një praktikë të mirë për legalizimin e mbi 3000 objekteve pa dokumentacion pronësie, duke u fokusuar në përmirësimin e efikasitetit dhe ofrimin e një shërbimi falas për qytetarët. Për këtë qëllim, u krijuan 35 grupe terreni të pajisura me teknologji për mbledhjen e të dhënave në kohë reale, u angazhuan inxhinierë vullnetarë dhe u përmirësua koordinimi me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Kjo praktikë është planifikuar të jetë një zgjidhje afatgjatë për menaxhimin e objekteve të paidentifikuara brenda një periudhe të përsheptuar, duke reduktuar kostot dhe kohën për qytetarët, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për të përmirësuar transparencën dhe efikasitetin e procesit.